



**VENDIM**

**Nr. 64 Datë 11.05.2017**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA NDRYSHIME NË  
MARRËVESHJEN E SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OST SH.A. DHE  
FURNIZUESIT MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE  
NR.23, DATË 15.02.2017.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20 gërma "h" të Ligjit Nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", pika 4 e VKM nr. 519, datë 13.07.2016 "Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike" dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 11.05.2017 pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE mbi propozimin e OST sh.a depozituar në ERE me shkresën nr 2933 prot datë 07.04.2017 për disa ndryshime në Marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a dhe furnizuesit, , miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr 23, datë 15.02.2017,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e disa ndryshimeve në Marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a dhe furnizuesit miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr.23, Datë 15.02.2017.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE**

**Petrit AHMETI**